



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:197406

Datë: 26.01.2024

Numri i dokumentit: 05245223

PPP. nr.865/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahimimi, në çështjen juridike përmbaremore të kreditorit KRU “P.” Sh.a, me seli në P., kundër debitorit A. Gj. nga P., rr., lidhur me çështjen përmbaremore, për shkak të borxhit në shumën prej 2.526.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhrorit përmbaremore P.nr.68/21, të datës 19.01.2021, të lejuar nga përmbareuesi privat Valdrin Beka për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datë .26.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht** prapësimi i debitorit A. Gj., nga P. dhe **SHFUQIZOHET** urdhri përmbaremore P.nr.68/21, i datës 19.01.2021, lejuar nga përmbareuesi privat Valdrin Beka, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për pjesën e detyrimit në shumë prej 2,240.85 €.
- II. REFUZHET pjesërisht** prapësimi i debitorit A. Gj., ashtu që **MBETET NË FUQI** pjesa tjetër e urdhrorit përmbaremore P.nr. 68/21 të datës 19.01.2021, i lejuar nga përmbareuesi privat Valdrin Beka, në shumë prej 285.15 €.

A r s y e t i m

Përmbareuesi privat, Valdrin Beka, si organ përmbareues, sipas propozimit të kreditorit KRU “P.” ka lëshuar urdhrin përmbaremore 68/21 të datës 19.01.2021, me të cilin ka lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstrakti nga librat e kontabilitetit, në shumë prej 2,526.00 €, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të urdhrorit t’i paguaj kreditorit borxhin prej 2,526.00 € si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Kundër urdhrorit përmbartimor P.nr.68/21 të datës 19.01.2021, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim debitori me ç' rast ka kundërshtuar propozimin për përmbartim të kreditorit, me arsyetim se me provat e paraqitura nuk është vërtetuar ligjshëm asnjë gjë për obligimin e paraqitur. Ka shtuar se në propozim thuhet se kërkohet vlera e obligimit të akumuluar nga data 31.12.2013 e deri më datë 31.12.2020, duke pas parasysh se ky obligim i tëri si i tillë është i parashkruar në mënyrë absolute. Tutje ka theksuar se sipas dispozitave të procedurës përmbartimore një kreditor i cili pretendon realizimin e një ekzekutimi, të njëjtin duhet ta dëshmojë me prova të palëkundura, të qarta dhe shumë të argumentuara, kurse në rastin konkret, meqë asnjëherë nuk më është kërkuar ex-officio nga kreditori që të bëjë pagesën e borxhit, nuk jam i informuar për borxhin në fjalë ndërsa tani dërgohem në përmbartim. I ka propozuar gjykatës që propozimin për ekzekutim ta hudhë poshtë si të palejuar dhe të hudhet poshtë si i pa ekzekutueshëm dhe të parashkruar në tërësi.

Kreditori në përgjigje në prapsim ka theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar, të pa argumentuar, si dhe të pa mbështetur në prova dhe në ligj. Sipas tij prapësimi i debitorit është i mangët në kuptim të nenit 69 par.4 i Ligjit për Procedurën Përmbartimore, kështu duhet të hidhet poshtë për mos mbështetje në nene të caktuara të ligjit të LPP dhe pa prova të vërtetuara. Ka shtuar se pretendimet e debitorit në lidhje me parashkrimin e borxhit nuk janë të qëndrueshme në kuptim të dispozitave të nenit 368 të LMD-së, sepse me datë 14.11.2017 debitori ka lidhur kontratë me kreditorin për riprogramimin e borxhit, ashtu që debitori vazhdimisht ka pohuar borxhin me pagesat të cilat i ka bërë ndaj kreditorit dhe atë pagesat e datave 10.12.2014, 14.11.2017 dhe ajo e datës 07.09.2018, duke pohuar kështu borxhin të cilin e ka ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar të pa argumentuar me prova dhe në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, nga këto arsye:

Sipas ekstraktit nga librat e kontabilitetit, gjykata gjeti se borxhi është kërkuar për periudhën nga data 01.01.2013 deri më datë 31.12.2020, në shumën totale prej 2,526.00 €, ndërsa propozimi për përmbartim lidhur me borxhin e lartcekur është paraqitur më datë 18.01.2021, i lejuar me urdhrin përmbartimor Nr. 68/21 të datës 19.01.2021.

Me nenin 29 par. 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* ndërsa me nën paragrafin 1.2. të këtij neni, si dokumente të besueshme parashihet: *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”* kurse me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se:

“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, andaj në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri përmbarrimor i lejuar nga përmbarruesi privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht ekstrakti nga librat e kontabilitetit, i cili përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, pasi që janë treguar palët, objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit dhe i njëjti plotëson kushtet e përcaktuara edhe me nenin 37 të LPP-së, pasi është dorëzuar në kopje të verifikuar.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e nenit 360 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, sipas të cilit parashihet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti: (1.1.) kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”,* ndërsa sipas paragrafit 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: *“afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”,* andaj rrjedhimisht duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, u vërtetua se kërkesat e kreditorit për shërbimet nga data 01.01.2013 e deri më datë 31.12.2019, në shumë prej 2,240.85 €, kanë arritur afatin e parashkrimit, kjo meqenëse propozimi për përmbarrim është paraqitur më datë 18.01.2021 dhe si të tilla kërkesat për periudhën e lartcekur kanë arritur më tepër së një vit nga koha e maturimit të së njëjtave për pagesë, ashtu siç është vendosur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Ndërsa për pjesën e mbetur sipas propozimit të kreditorit, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2020 deri më datë 31.12.2020, në shumën prej 285.15 €, gjykata erdhi në përfundim se borxhi lidhur më shërbimet e ofruara për gjatë kësaj periudhe, nuk ka arritur afatin e parashkrimit sipas dispozitave të lartcekura, meqenëse propozimi për përmbarrim është paraqitur më datë 18.01.2021, andaj vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 43 par. 4 të Ligjit Nr. 04/L-139 të Procedurës Përmbarrimore, parashihet se: *Përmbarruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarrueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarrueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngreh kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim.”*

Gjykata, analizoj edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse të parashtruara përmes prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk do të ndikonin në vendosjen ndryshe si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, prandaj pjesërisht shfuqizoi urdhrin përmabrimor.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.865/21, datë 26.01.2024

Gj y q t a r j a
Fatbardha Uka Ibrahim

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.